

Progetto



Tuscany Empowerment Actions for Migrants System



ISTITUTI KOMPRESIV SHTETËROR

Prindërve  
Mësuesve  
Personelit ATA

Subjekti: Komunikim për aktivizimin e detyrueshëm të **PagoInRete** për pagesat telematike të familjeve ndaj Istitutit.

Faqja e internetit PagoPA do të jetë **e detyrueshme dhe ekskluzive** për të kryer të gjitha pagesat ndaj të gjitha Administratave Publike duke filluar nga data 01/03/2021. Për Istitutet shkollorë sistemi i pagesës PagoPa është PagoInRete.

Duke u futur në web-portalin të MUIR – duke përdorur PC, smartphone ose tablet – familjet mund:

- të shohin situatën komplekse të të gjitha lajmërimeve telematike që i përkasin fëmijëve të tyre, të lëshuara dhe nga shkolla të ndryshme.
- të paguajnë një ose më shumë njoftime në të njëjtën kohë, duke përdorur mjetet më të zakonshme të pagesës dhe duke zgjedhur në listën e PSP (Prestatori di servizi di pagamento/Ofruesit e shërbimeve të pagesës) atë më të leverdisshme.

Prindëri do të marrë me anë të emailit konfirmimin e pagesës së kryer dhe mund të shkarkojë faturën telematike dhe/ose certifikacionin e vlefshëm për zbritje të mundshme të taksave.

Familjet mund të futen në shërbimin “PagoInRete” nga faqja e internetit MUIR:

<http://www.istruzione.it/pagoindre/>

Mbi mënyrat e përdorimit të faqes së internetit ju lutem referojuni leximit të manualit të përdoruesit të disponueshëm në adresën:

[http://www.istruzione.it/pagoindre/files/manuale\\_utente\\_famiglia.pdf](http://www.istruzione.it/pagoindre/files/manuale_utente_famiglia.pdf)

Prindërit/tutorët janë të ftuar, nëse nuk e kanë bërë më parë, të regjistrohen në portalin e PagoInRete brenda datës **28/02/2021** duke kryer operacionet e renditura më poshtë:

- 1 Prindëri/tutori I cili ka prezantuar kërkesën e regjistrimit online, rezulton tashmë i regjistruar dhe mund të hyjë në Pagoinrete me të njëjtat të dhëna; është e mundur gjithashtu të hyni me anë të identitetit digjital SPID.  
Prindëri/tutori i cili nuk ka të dhënat duhet të kryej regjistrimin e përdoruesit në portalin e MUIR; me anë të linkut të dedikuar, i pranishëm në Homepage, lartë, djathtas, futemi në faqen e regjistrimit të përdoruesit për të shkruajtur të dhënat tona anagrafike dhe një adresë e-maili si kontakt; gjatë regjistrimit, sistemi do të lëshojë të dhënat për të hyrë në sistem (username/emri i përdoruesit) dhe do të kërkojë përdoruesit të vendosi fjalëkalimin e tij (password) për hyrjen në sistem. Më pas prindëri do të përmbahet udhëzimeve të faqes së internetit Pagoinrete.



UNIONE EUROPEA



- 2 Përdoruesi i regjistruar (një prindër/tutor për çdo nxënës) duhet ti komunikojë shkollës ku është regjistruar fëmija i tij, vullnetin për të marrë pjesë në shërbimin e pagesave duke kërkuar të jetë i lidhur me nxënësin frekuentues për të shikuar kështu komunikimet telematike në emër të tij.

Ky operacion do të kryhet me anë të plotësimit të disa FORMULARËVE TË BASHKANGJITUR, nga ana e prindërit/tutorit të regjistruar, të cilët duhet ti dorëzohen shkollës sa më parë të jetë e mundur, të kompletuar me çdo informacion të kërkuar.

Mbasi sekretarja të konfermojë lidhjen prindër – fëmijë, duke u futur në portalin MUIR, përdoruesi do të gjendet i abilituar automatikisht në shërbimin e pagesave dhe do të shohë komunikimet në lidhje me fëmijët e tij.

Nëse nuk jeni në gjendje të kryeni pagesën me anë të instrumenteve elektronike, (kartë krediti, transferim bankar, etj.) është e mundur të stampohet, gjithmonë nga Portali PagoInRete, formulari i pagesës për të paguar në dyqanet e basteve, pikat tabacchi dhe bankat që kryejn shërbimin ATM, sportele, APP në smartphone, tablet ose shërbim ofruesve të jerë të cilët orojnë shërbime me pagesë.